



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AAB Construction" Sh.P.K. të datës 29.05.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "152-Rregullimi i terreneve sportive - Rregullimi i oborreve në kopshte parashkollore" me nr. të prokurimit 616-26-3603-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AAB Construction" Sh.P.K. të datës 29.05.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "152-Rregullimi i terreneve sportive - Rregullimi i oborreve në kopshte parashkollore" me nr. të prokurimit 616-26-3603-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "AAB Construction" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 9.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "152-Rregullimi i terreneve sportive - Rregullimi i oborreve në kopshte parashkollore" me nr. të prokurimit 616-26-3603-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

### **Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

*“Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kërkesa 2, është kërkuar që të ofrohet:*

*Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme b) Inxhinier i diplomuar i industrise se drurit se paku 5 vite pervoj pune pas diplomimit.*

*Lidhur me Kërkesën 2, pika b), ku është kërkuar “Inxhinier i diplomuar i industrisë së drurit me së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit”, konsiderojmë se kjo kërkesë është joproporcionale dhe kufizuese për konkurrencën. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm se pse kërkohet pikërisht përvojë minimale 5 vjeçare pas diplomimit për këtë profil profesional, duke marrë parasysh natyrën e kontratës. Një inxhinier i industrisë së drurit edhe me më pak vite përvojë profesionale mund të realizojë me sukses obligimet që lidhen me këtë projekt. Vendosja e pragut kaq të lartë të përvojës pa arsyetim objektiv kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të përcaktuar me nenin 7 dhe nenin 69 të LPP-së. Kërkojmë nga ana juaj që të rishikohet kriteri i vendosur.*

*Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kërkesa 3. OE duhet të ofroj certifikaten per cilesin e gomes dhe standardin e tyre EN 1177 + AC EN1176-1 në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kërkesa 3, ku kërkohet që OE të ofrojë certifikatën për cilësinë e gomës dhe standardet EN 1177 + AC EN1176-1, konsiderojmë se kërkesa që këto certifikata të dorëzohen në fazën e ofertimit është e tepruar dhe e panevojshme. Operatori Ekonomik mund të ofrojë certifikatat përkatëse, standardet dhe mostrat e produkteve para furnizimit, gjatë fazës së implementimit apo pas nënshkrimit të kontratës, sipas kërkesës së menaxherit të kontratës. Kërkesa që këto dokumente të dorëzohen që në fazën e ofertimit krijon barrë të panevojshme administrative dhe kufizon konkurrencën.*

*Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kërkesa 6. Operatori Ekonomik ose Furnizuesi i OE duhet të dorëzojë Certifikatat Standarde të Produkteve në bazë të • EN 1176-1; • EN 1176-2; • EN 1176-3; • EN 1176-5; • EN 1176-6+AC; • EN 1176-11; -konsiderojmë se kërkesa për dorëzimin e të gjitha këtyre certifikatave në fazën e ofertimit është e panevojshme dhe joproporcionale. Operatorët ekonomikë mund t'i dorëzojnë certifikatat përkatëse dhe mostrat e produkteve para furnizimit apo pas nënshkrimit të kontratës, sipas kërkesave të menaxherit të kontratës dhe në përputhje me specifikat teknike të projektit.*

*Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kërkesa 7. Operatori Ekonomik ose Furnizuesi i OE duhet të dorëzojë Certifikaten Standarde të Produkteve nga druri për menaxhimin dhe prodhimin e lëndës drusore , brenda nje organizate qe domostrom produktet të etiketuara dhe qe vijnë nga pyje të menaxhuara mire • FSC-STD-40-004 V3-1 Po ashtu, në Kërkesën 7, ku kërkohet certifikata FSC-STD-40-004 V3-1 për produktet nga druri, konsiderojmë se kërkesa për dorëzimin e kësaj certifikate në fazën e ofertimit është e tepruar dhe e panevojshme. Operatori Ekonomik mund të dëshmojë përputhshmërinë e produkteve dhe standardeve përkatëse para furnizimit apo gjatë implementimit të kontratës. Kërkesa për dorëzimin paraprak të këtyre dokumenteve kufizon pjesëmarrjen dhe krijon barriera të panevojshme për operatorët ekonomikë. Po ashtu, praktika e kërimit të certifikatave të produkteve që në fazën e ofertimit nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi cilësia dhe përputhshmëria e produkteve mund të verifikohet edhe gjatë fazës së implementimit të kontratës, para furnizimit apo përmes mostrave të kërkuara nga menaxheri i kontratës.*

*Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 – Kërkesa 8. OE duhet të*

ofrojë katalogun e produkteve që i prodhon ose marrëveshje me ndonjë prodhues për furnizim për të gjitha produktet e kërkuara sipas specifikimit teknik. Në rast se OE paraqet marrëveshjen duhet të bashkangjisë edhe katalogun e prodhuesit të nënshkruar dhe vulosur nga vetë prodhuesi.

Ndërsa në Kërkesën 8, ku kërkohet që OE të ofrojë katalogun e produkteve ose marrëveshje me prodhues për furnizim dhe katalogun e nënshkruar dhe vulosur nga prodhuesi, konsiderojmë se kjo kërkesë është e tepruar në fazën e ofertimit. Operatori Ekonomik mund të dorëzojë katalogjet, marrëveshjet me prodhuesit dhe dokumentacionin përcjellës pas nënshkrimit të kontratës dhe para realizimit të furnizimit. Kërkesa për sigurimin e këtyre dokumenteve që në fazën e ofertimit krijon kufizim të panevojshëm të konkurrencës dhe favorizon operatorë të caktuar ekonomikë. Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet që kriteret e vendosura të mos kenë efekt eliminues ndaj operatorëve ekonomikë që posedojnë kapacitet real për realizimin e kontratës, por që nuk kanë siguruar paraprakisht dokumentacion të panevojshëm në fazën e ofertimit.

**Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit,** është gjetur se kërkesat për stafin profesional, certifikatat lidhur me standardet e cilësisë dhe katalogjet, janë absolutisht të domosdoshëm për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin njësisë kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 03.06.2026**

**Visar SHEHU**  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.